
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: Euro Abi SHPK, P.N. E TIRANES – VITI Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	04.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **04.06.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Euro Abi SHPK**, me adresë në **Viti**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN SAPNIQ**, me Numër të prokurimit: **623-24-1691-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-022-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Euro Abi SHPK**, me adresë në **Viti**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN SAPNIQ**, me Numër të prokurimit: **623-24-1691-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-022-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **30.05.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-1691-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-022-5-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **Euro Abi SHPK**, me adresë në **Viti**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN SAPNIQ**, me Numër të prokurimit: **623-24-1691-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-022-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **30.05.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **04.06.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit *B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf profesional:
2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi
Infrastruktura Rrugore, me përvojë pune ne projektim min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

• **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: **Udhëheqësi i Punishtes**, keni prezantuar z. **Jasmir Morina;**



Datë: 20.05.2024

VENDIM PËR CAKTIMIN E UDHËHEQËSIT TË PUNISHTËS

Bazuar në kërkesën e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Rahovecit, dhe në përputhje me dosjen e tenderit me numër të prokurimit 623-24-1691-5-1-1 për projektin "Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Sapniq", kompania "N.N.P. EURO CONSTRUCTION", në emër të grupit merr vendim për caktimin e z.Jasmir Morina si udhëheqës te punishtes.

Informacione të Projektit:

AK: KOMUNA E RAHOVECIT
Titulli: RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN SAPNIQ
Nr. i Prokurimit: 623-24-1691-5-1-1

Profil i z. Jasmir Morina:

Z. Jasmir Morina është një inxhinier i ndërtimtaris me specializim konstruktivë me përvojë të gjerë në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të ndërtimit. Ai ka demonstruar aftësi të shkëlqyera profesionale dhe njohuri të thella teknike në fushën e ndërtimit. Me një karrierë të suksesshme dhe një provojë të disa vjetësh, ai është i përshtatshëm për t'u caktuar si udhëheqës i punishtes në këtë projekt.

Efektet e Vendimit:

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të zbatohet me efekt të plotë.

Përfaqësues i Kompanisë

N.N.P. "EURO CONSTRUCTION"



1

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, është kërkuar: Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore, me përvojë pune ne projektim min. 5 vite pas diplomimit; Inxhinieri në fjalë është Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv e Jo Drejtimit Infrastruktura Rrugore, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Arsyeja 1. Ju njoftoj se ju si OE nuk i keni plotesuar kerkesat minimale sipas dosjes se tenderit te seksionit II Fleta e Te Dhenave te Tenderit

Kapaciteti Teknik dhe Profesional: **Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 8 vite pas diplomimit**

Ne si OE kemi prezantuar Jasmir Morina i cili e ploteson kerkesen e AK, pra ky pretendim i AK eshte i pabazuar,

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

2.6. Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Një (1) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

• **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt; Sqarimet janë si në vijim:**

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, keni prezantuar z. **Samir Sadiku**;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, nga dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt; Marrëveshja mbi angazhim (Kontratë për Shërbime) nuk është për këtë projekt:

1.Përshkrimi i Punës:

Kontraktuesi është emëruar si fitues i tenderit “NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE”, të organizuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Rahoveit. Kontraktori, Samir Sadiku, do të kryejë dhe do të drejtojë të gjitha punët në menaxhimin e emergjencave.

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf teknik:

3.3. Një (1) punëtor manipulues i makinerive ndërtimore, duhet të jetë i trajnuar në fushën për siguri në vendin e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për siguri dhe shëndet në punë;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

• **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt; Sqarimet janë si në vijim:**

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Një (1) punëtor manipulues i makinerive ndërtimore, keni prezantuar z. **Bujar Shkodra**;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, nga dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt; Marrëveshja mbi angazhim (Kontratë për Shërbime) nuk është për këtë projekt:

1.Përshkrimi i Punës:

Kontraktuesi është emëruar si fitues i tenderit “NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE”, të organizuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Rahoveit. Kontraktori, Bujar Shkodra, do të kryejë dhe do të drejtojë të gjitha punët në menaxhimin e emergjencave.

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Arsyeja 2. Kërkesa e DT sipas AK ka qene: **Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Një (1) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit**

Ne si OE kemi prezantuar z.Samir Sadiku mirepo per faktin se dy tendere kan qene per tu dorezuar ne te njejten kohe per shkak te presionit te kohes e kemi leshuar si gabim teknik, dhe AK ka qene i obliguar te kerkoj sqarime lidhur me kete qeshtje.

Dokumentet në fjale nuk mund të kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Po ashtu në ofertën e juaj të dorëzuar nuk e keni plotësua Kërkesën Nr. 3, përkatësisht 3.1; 3.2 dhe 3.4, Kërkesën Nr. 4, Kërkesën Nr. 5 dhe Kërkesën Nr. 6 të Kapaciteti teknik dhe profesionale, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Me date 03.05.2024 na eshte ofruar qasja pasi qe e kemi kerkuar, dhe pas kontrollimit te dokumenteve te OE te rekomanduar per kontrate kemi gjetur nje ser shkeljesh nga ana e AK per faktin se GOE Mendi - P shpk dhe Valdrini - A shpk, eshte i papergjegjshem dhe nuk ka arrit qe te plotesoj kerkesen 2 tek kapaciteti ekonimik dhe financiar ku thuhet: **Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose mbështetje të pakushtëzuar nga Institucioni Bankar, në vlerë prej së paku: 200,000.00 €, në rast te koncersiumit duhet te sigurohet nga Lideri ne emër te liderit te grupit.**

GOE ka prezantuar letembeshtetjen ku thot qe Banka Raiffaisen do ta shqyrtoj kerkesen e OE per nje kreditim te tille konform kushteve dhe kriterete te brendshme te bankes dhe BQK-se, qe i bie se banka nuk e ka marr persiper nje mbeshtetje te tille financiare.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, e ka plotësuar Kërkesë Nr. 2 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, ku Dokumentin e dorëzuar nga Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Ku ndër të tjera Banka thotë:

Ne, konfirmojmë që bazuar pasqyrat financiare të prezantuar do të financojmë Mendin P SH.P.K., Rahovec, Fsh. Kramovik n.n, Kosovë, me EURO 200,000.00 (Me fjalë: Dyqind mijë Euro), kredi të pakushtëzuar për implementimin e projektit/tenderit: Rregullimin e shtratit te lumit në fshatin Sapniq, me nr. të Prokurimit: 623-24-1691-5-1-1

Nëse Mendi P SH.P.K., Rahovecë Fsh.Kramovik|n.n, Rahovecë, Kosovë nuk shpallet fitues i ketij tenderi, atëhere, kjo letër mbështetje do të përfundoj së prodhuari efekt juridik

Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Poashtu ky OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjeshem per faktin se nuk ka arritur qe te deshmoje se ka perfunduar 1,110.000.00 euro pune te ngjashme ne tri vitet e fundit mirepo ka paraqitur vetem referenca per kryerje te puneve mirepo ato pune jan perfunduar ne vitet 2018-2019-2020 dhe nuk bejne pjese ne tri vitet e fundit pasi qe edhe ne si OE mund te paraqesim kerkese per reference pran ndonje AK per ndonje pune te cilen e kemi perfunduar ne vitin 2016 e kjo nuk do te thot qe puna ka perfunduar sot.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara, pasi që Grup i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për kontratë, e ka plotësuar Kërkesë Nr. 4 të Kapaciteti teknik dhe professional, ku Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve të prezantuara në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, janë në vlerë prej: 1,706,712.67 Euro, andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit